



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK

Nr 141 Prot.

Gjirokastër, më 27 / 01 / 2020

V E N D I M

Nr. 06 , datë 27.01 . 2020

MIRATIMI I NGRITJES SË KOMISIONIT PËR HARTIMIN E RREGULLORES SË
ZGJEDHJEVE PËR AUTORITETE DHE ORGANEVE DREJTUESE
TË UNIVERSITETIT "EQREM ÇABEJ"

Në mbështetje të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 102, pika 4 , Ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 131, si dhe Urdhërit të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, **nr. 8 datë 14. 01. 2020** "*Për procesin zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë*", Senati akademik i Universitetit "Eqrem Çabej" në mbledhjen e tij të datës 27. 01. 2020 pasi diskutoi për ngritjen e komisionit për hartimin e rregullores së zgjedhjeve për autoritete dhe organe drejtuese të Universitetit "Eqrem Çabej" (2020 – 2024) ,

V E N D O S I;

1. Komisioni për hartimin e rregullores së zgjedhjeve 2020 - 2024 të përbëhet prej pesë anëtarësh me këtë përbërje:
 - a. Juristi i institucionit
 - b. Tre përfaqësues të personelit akademik, nga një për secilën njësi kryesore (FESHSH, FSHN , FE).
 - c. Një përfaqësues i trupës së studentëve.
2. Përfaqësuesit e personelit akademik dhe përfaqësuesi studentor vetëkandidojnë.
3. Përfaqësuesit e personelit akademik nuk duhet të jenë autoritete të zgjedhura, si dhe kandidatë për autoritete dhe organe drejtuese në zgjedhjet e institucionit, **8 maj 2020**.

4. Përfaqësuesi studentor duhet të jetë student me kohë të plotë dhe të mos jetë kandidat për anëtar të Senatit Akademik në zgjedhjet e institucionit, **8 maj 2020**.
5. Aplikimi bëhet pranë sekretarisë së Senatit akademik në datat **27 dhe 28 janar 2020**, deri në orën 16.00.
6. Kandidaturat votohen në Senatin Akademik në datën **29 janar 2020, ora 11.00**.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof.dr. Bektash MEMA

